VENDIM
Nr. 203, datë 3.4.2024

PËR KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKITË DURRËS, KRUJË, KURBIN, RROGOZHINË, SHIJAK DHE VORË TË OBJEKTEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi te bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin, Rrogozhinë, Shijak dhe Vorë të 11 (njëmbëdhjetë) objekteve arsimore, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin, Rrogozhinë, Shijak dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m^2)	Vlera e projektidesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrjes	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
1	Durrës	Durrës	Sukth	9 - vjeçar + I mesëm	Shkolla e Mesme të Bashkuar "Ismet Nanushi", Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	7260	694,552.08	329,499,178.87	3,022,020.08	1,282,447.00	334,498,198.03
				Kopsht	Kopshti "Ismet Nanushi", Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës			450					
2	Durrës	Krujë	Thumanë	9 - vjeçar + I mesëm	Shkolla e Mesme të Bashkuar "Haxhi Qira", Borizanë, Bashkia Krujë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	2300	465,760.00	137,887,263.88	1,610,180.00	378,158.00	140,341,361.88
3	Durrës	Krujë	Krujë	Kopsht	Kopshti Derede, Bashkia Krujë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	930	465,760.00	46,502,428.47	1,610,180.00	123,312.00	48,701,680.47
4	Durrës	Krujë	Bubq	9 - vjeçar + Kopsht	Shkolla 9-vjeçare dhe kopshtit "Gjergj Kastrioti", Bilaj, Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	1820	449,025.00	106,569,145.00	2,059,575.00	157,840.00	109,235,585.00
5	Durrës	Krujë	Krujë	Kopsht	Kopshti Varosh, Bashkia Krujë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	427	394,777.00	46,018,635.00	2,096,400.00	263,000.00	48,772,812.00
6	Durrës	Krujë	Fushë Krujë	9 - vjeçar + Kopsht	Shkolla 9-vjeçare dhe kopshtit "Iliria", Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë	Ndërtim	Fondi i Mbështetjes për Rimëkëmbjen e Arsimit, financuar nga Qeveria e Kroacisë	1061	515,000.00	87,134,429.95	1,855,625.00	97,959.95	89,603,014.90
7	Lezhë	Kurbin	Laç	Kopsht	Kopshti nr. 2, Laç, Bashkia Kurbin	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	1144	426,262.50	106,155,735.99	2,941,987.17	135,673.34	109,659,659.00
8	Lezhë	Kurbin	Mamurras	Kopsht	Kopshti nr. 1, Mamurras, Bashkia Kurbin	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	600	596,112.00	59,124,998.30	2,273,810.00	265,000.00	62,259,920.30
9	Tiranë	Rrogozhinë	Lekaj	Kopsht	Kopshti Okshtun, Bashkia Rrogozhinë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	128	286,387.20	18,358,994.65	1,530,381.60	15,180.23	20,190,943.68
10	Durrës	Shijak	Shijak	Kopsht	Kopshti nr. 2, Bashkia Shijak	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	405.7	459,000.00	40,077,992.80	1,283,125.00	48,149.80	41,868,267.60
11	Tiranë	Vorë	Bërxullë	9 - vjeçar	Shkolla 9-vjeçare Bërxullë, Bashkia Vorë	Ndërtim	Bashkimi Evropian - Projekti "BE për Shkollat"	2512	459,000.00	136,313,564.90	1,283,125.00	297,912.09	138,353,601.99